



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UJËSJELLËS KANALIZIME TIRANE SH.A.
DREJTORIA E PROKURIMEVE
SEKTORI I INVESTIMEVE DHE PROJEKTEVE

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ____/____/2019

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Për: Bashkimi i operatorëve ekonomik 1. **“L.T.E Construction sh.p.k,** me administrator Z.Artur Caushaj, me numër NIPT-i L78006801F me adresë: Fier Ballsh, Bulevardi Rrapo Hekali, lagjja 5-Shkurti, prane Zyre se Punes, kati i pare, zona Kadastrale 1079, Ballsh-Mallakaster 2. **“Shendelli” shpk** me administrator Z. Yzedin Bozhaj, me numër NIPT-i K07924803N me adresë: Lagjia “Kastiot”, Dy kullat, Fier.

Procedura e prokurimit: “Procedurë e Hapur”

Numri i referencës së procedures: REF-02207-12-27-2018

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Instalimi i sistemit ujemates ne burimet e ujesjellesit te Tiranes”

Fondi Limit: 26.546.905 (njëzet e gjashtë milion e pesëqind e dyzet e gjashtë mijë e nëntëqind e pesë) lekë pa TVSH

Burimi i financimit: Të ardhurat e SH.A Ujësjiellës-Kanalizime, Tiranë.

Kohëzgjatja: 3 muaj nga data e lidhjes së kontratës.

Data e zhvillimit të tenderit është: 28.01.2019 Ora: 09:00

Buletini i Njoftimeve Publike: Nr.52 të dates 31/12/2018

Njoftojmë se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Bashkimi i Operatoreve ekonomik **“Iliriada” sh.p.k.** NIPT-it J61828125L
“Ed Konstruksion” sh.p.k NIPT-it K61625001I

Vlera: **24.147.761,4** (njëzetë e katër milion e njëqind e dyzetë e shtatë mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e një presje katër) lekë pa TVSH.

2. Bashkimi i Operatoreve ekonomik **“L.T.E Construction shpk & “Shendelli” shpk** përfaqësuar me prokurë të posaçme nr.240 rep. dhe nr.71 kol. nga shoqeria “L.T.E Construction shpk

“L.T.E Construction sh.p.k
“Shendelli” shpk

NIPT-i L78006801F
NIPT-i K07924803N

Vlera: **24.592.244** (njëzetë e katër milion e pesëqind e nëntëdhjetë e dy mijë e dyqind e dyzetë e katër) lekë pa TVSH.

3. Operatori Ekonomik **“SENKA” shpk** NIPT-i J94808405Q

Vlera: **25.243.674** (njëzet e pesë milion e dyqind dyzet e tre mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e katër) lekë pa TVSH.

4. Operatori Ekonomik **“KEVIN KONSTRUKSION” sh.p.k** NIPT-i K71401004W

Vlera: **0 (zero)** lekë.

5. Operatori Ekonomik **“KUPA” Sh.p.k.** NIPT-i K51615512C

Vlera: **26.063.537,85** (njëzet e gjashtë milion e gjashtëdhjetë e tre mijë e pesëqind e tridhjetë e tre presje tetëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. **Oferta e paraqitur nga bashkimi i operatoreve B.O.E “Iliriada sh.p.k & “Ed Konstruksion sh.p.k” SH.P.K,** me vlerë të ofertës **24.147.761,4** (njëzetë e katër milion e njëqind e dyzetë e shtatë mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e një presje katër) lekë pa TVSH.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi realizoi kontrollin për gabime aritmetike të ofertës së paraqitur në tender në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar neni 66, konstatoi se oferta është paraqitur pa gabime aritmetike në vlera.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të nenit 53 të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe Kreut VII, neni 66, pika 3 të VKM Nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga ky Operator ekonomik, nga ku rezultoi si më poshtë:

Së PARI: Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik KVO konstaton se operatori ekonomik “Iliriada sh.p.k nuk ka paraqitur Kopje të çertifikuara të bilanceve të 2 viteve ushtrimore 2015 dhe 2016. për të dëshmuar plotësimin e kriterit Nr1, kapaciteti ekonomik dhe financiar të kërkuar në DST.

Operatori ekonomik “Iliriada sh.p.k ka paraqitur vetëm Kopje të bilancit të vitit ushtrimore 2017, e cila është e pakonfirmuar nga Dega e Tatim Taksave, si rrjedhojë do të konsiderohet **i pavlefshëm**.

Nga sa më sipër shoqëria “Iliriada sh.p.k nuk ka paraqitur bilancet për vitin 2015, Vitin 2016 dhe Vitin 2017, sipas formatit të kërkuar në kriteret kualifikuese.

Shoqëria “Iliriada sh.p.k në vërtetimin e paraqitur nga administrata tatimore ka paraqitur xhiro vjetore për vitin 2017. Ndërkohë që nga Autoriteti Kontraktor në dokumentat e tenderit është kërkuar deklarimi i xhiros vjetore për tre vitet e fundit dhe konkretisht (2015, 2016, 2017)

Nga sa më sipër shoqëria “Iliriada sh.p.k nuk ka paraqitur xhiron vjetore për vitin 2015 dhe Vitin 2016.

Pra sa më sipër shoqëria “Iliriada sh.p.k nuk zotëron kapacitet të mjaftueshem ekonomik dhe financiar për sa i përket Balanceve dhe Xhiros së shoqërisë për të realizuar kontratën për këtë objekt prokurimi duke mos përmbushur Kriteret e veçanta për kualifikim, Kapaciteti *Ekonomik dhe Financiar*, pika 2.2/1, dhe 2.2/2, cka bie në kundërshtim me pikën 1 gërma (c) të nenit 46 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar ku përcaktohet se:

Operatorët ekonomik, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtëme që AK i vlerëson të nevojshme.....

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjykon se anëtari i bashkimit të përkohshëm të shoqërive “**Iliriada sh.p.k** është në kushtet e mospërmbushjes së kriterëve të veçanta të kualifikimit pasi nuk ka përmbushur kapacitetet financiare që ai duhet të plotësohej referuar VKM nr.914 datë 29.12.2014 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”neni 74 pika 3.

Në shtojcën 11 shprehimisht parashikohet se.... *Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim..*

Së DYTË Operatorët ekonomik “Iliriada sh.p.k dhe “Ed Konstruksion sh.p.k” SH.P.K janë paraqitu si Bashkimi Operatorësh , bashkim i cili është krijuar me anë të kontratës së bashkëpunimit me Nr. 773 rep., nr. 117/1 kol me anë të së cilës kanë ndarë detyrat përkatësisht:

Shoqëria “Iliriada sh.p.k do të kryej 20 % të punimeve duke marrë përsipër realizimin e punimeve si më poshtë vijon:

- **Stacioni Pompimit Baldushk**
- **Stacioni Pompimit Picall-Stërmas**
- **Stacioni Pompimit Pezë-Celje**
- **Stacioni Pompimit Peze-Helmes**
- **Stacioni Pompimit Zhurje**
- **Stacioni Pompimit Ndroq Lagja e Re**
- **Stacioni**

Open
Procurement
Albania

Pompimit

Vaqarr

Shoqëria “Ed Konstruksion sh.p.k” do të kryej 80% të punimeve duke marrë përsipër të kryej të gjitha punimet të cilat nuk do të kryhen nga “Iliriada sh.p.k.

Vlenë të theksojmë se “Iliriada sh.p.k në zërat e punimeve të cilat ka marrë përsipër të kryej ka zëra punimesh me natyrë: Furnizim/Vendosje paisje elektrike (Stacionet elektrike për secilin Stacion pompimi) dhe punime ndertimor (gërmim, ndërtim pusetash etj)

Për zbatimin e punimeve të cilët ka marrë përsipër Operatori ekonomik “Iliriada sh.p.k ka paraqitur punonjësit e mëposhtëm:

1.Ing. Ndertimi punonjësin O.P,

Ndërkohë, ky Operator nuk ka paraqitur inxhinier Hidroteknik, 1(një) inxhinier elektronik, inxhinier elektrik me qëllim realizimin e kontratës, si dhe nuk ka paraqitur asnjë punonjës të pajisur me dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente me të.

Mbështetur në Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 74, pika 3 i cili sanksionon: *”Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në akt marrëveshje.*

Nga sa më sipër OE “Iliriada” sh.p.k nuk përmbush kriterin mbi stafin inxhinierik dhe mbi punonjësit e pajisur me dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente me të, të kërkuar në DST, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë.

Së TRETË: Autoriteti Kontraktor ka kërkuar ti vihet në dispozicion tre kamioncina kapaciteti mbajtës duhet të jetë minimum 1.5 ton dhe maximum 2 ton secili kamion për ekzekutimin e kontratës. Bashkimi I Operatorëve Ekonomik në përmbushje të këtij kriteri ka paraqitur vetëm një kamionçinë me tonazhin e kërkuar nga AK.

Pra sa më sipër cituar dokumentacioni i paraqitur nga Bashkimi I Operatorëve Ekonomik lidhur me shtojcën 10, është i paplotë lidhur me kamionçinë vetshkarkues me kapacitet mbajtes minimumi 1.5 ton dhe maksimumi 2 ton për secilin kamion te kerkuar nga AK (3 cope), për rrjedhojë i pavlefshëm.

Autoriteti Kontraktor ka kërkuar ti vihet në dispozicion tre kamiona vetshkarkues kapaciteti mbajtës duhet të jetë minimum 3.5 ton dhe maximum 5 ton secili kamion për ekzekutimin e kontratës. Bashkimi I Operatorëve Ekonomik në përmbushje të këtij kriteri nuk ka paraqitur asnjë kamion me tonazhin e kërkuar nga AK.

Pra sa më sipër cituar dokumentacioni i paraqitur nga Bashkimi I Operatorëve Ekonomik lidhur me shtojcën 10, është i paplotë lidhur me kamionçinë vetshkarkues me kapacitet mbajtes minimumi 3.5 ton dhe maksimumi 5 ton për secilin kamion te kerkuar nga AK (3 cope), për rrjedhojë i pavlefshëm.

Për sa më sipër Dokumentacioni i paraqitur nga Bashkimi I Operatorëve Ekonomik i mësipërm është i paplotë pasi nuk ka përmbushur kriteret e Veçanta të Kualifikimit/ Kapaciteti Teknik duke mos paraqitur mjetet në mënyrën e kërkuar në dokumentat standarte të tenderit të kërkuar nga AK;

Pra sa më sipër Bashkimi I Operatorëve Ekonomik nuk zotëron kapacitet të mjaftueshem teknik për sa i përket mjeteve për të realizuar kontratën për këtë objekt prokurimi duke mos përmbushur Kriteret e veçanta për kualifikim, Kapaciteti Teknik dhe profesional, , cka bie në kundërshtim me pikën 1 gërma (a) dhe (b) të nenit 46 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar ku përcaktohet se: *Operatorët ekonomik, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtëme që AK i vlerëson të nevojshme.....*

Gjithashtu sqarojme se nuk jemi në kushtet e nenit 53, pika 1 e LPP në të cilin përcaktohet se *“Autoriteti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa cënuar dispozitat e parashikuara në nenet 32 dhe 33 të këtij ligji, nuk duhet të kërkohej, ofrohet apo lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në çmim apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme”,* pasi sqarimet mund të kërkohej vetëm në rast se autoriteti kontraktor e shikon të nevojshme dhe arsyeshme për vërtetësinë e dokumentacionit dhe jo në rastin konkret.

Në këtë rast K.V.O është e detyruar të zbatojë nenin 55/2 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin Publik" në të cilën citohet se ...*Autoriteti Kontraktor vlereson dhe krahason ofertat e vlefshme për të përcaktuar ofertën fituese në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në dokumentat e tenderit.*

Pra, përfundimisht K.V.O gjykon se duhet të vlerësojë përmbushjen e çdo kriteri për kualifikim që gjendet në DT dhe operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatitin ofertat dhe të paraqesin të plotë dokumentacionin e kërkuar në DT.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 53 pika 5, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për Prokurimin publik" (i ndryshuar) dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", Kreu VII, Neni 66 pika 3, **e shpall të pavlefshme** këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

2. Oferta e paraqitur nga Operatori ekonomik "Kevin Construction" sh.p.k me vlerë të ofertës 0 (zero) lekë pa TVSH

Pas hapjes së ofertave, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se shoqëria **"Kevin Construction" sh.p.k** nuk ka paraqitur në sistemin elektronik ofertën ekonomike dhe dokumentacionin e plotë ligjor e teknik të kërkuar në Shtojcën 12, të dokumenteve të tenderit për këtë procedurë.

Ky fakt i konstatuar nga KVO-ja u regjistrua në procesverbalin e vlerësimit të Ofertave. Mungesa e ofertës ekonomike u konfirmua nga të gjithë anëtarët e KVO-së në tërësi.

Përsa më sipër, Operatori Ekonomik **"Kevin Construction" sh.p.k** s'kualifikohet pasi nuk ka paraqitur dokumentacionin e plotë ligjor dhe teknik dhe Formularin e Çmimit të Ofertës sipas Shtojcës 1 dhe preventivin e detajuar sipas zërave përkatës, kërkesa këto të përcaktuara në Kriteret e Përgjithshme të Kualifikimit dhe Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Shtojca 12, e dokumenteve standarte të tenderit për këtë procedurë.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për "Prokurimin publik", i ndryshuar dhe mbështetje të Kreu VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për "Miratimin e rregullave të prokurimit publik", **e shpall të pavlefshme këtë ofertë** pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

3. Oferta e paraqitur nga Operatori Ekonomik "SENKA" sh.p.k me vlerë të ofertës 25.243.674 (njëzet e pesë milion e dyqind dyzet e tre mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e katër) lekë pa TVSH.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi realizoi kontrollin për gabime aritmetike të ofertës së paraqitur në tender në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.914, datë 29.12.2014 për "Miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar neni 66, konstatoi se oferta është paraqitur pa gabime aritmetike në vlera.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të nenit 53 të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për "Prokurimin publik", i ndryshuar, dhe Kreut VII, neni 66, pika 3 të VKM Nr.914, datë 29.12.2014 për

“Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga ky Operator ekonomik, nga ku rezultoi si më poshtë:

Se pari: Nga shqyrtimi i dokumentacionit në sistemin elektronik KVO vëren se Operatori Ekonomik “SENKA” sh.p.k **nuk ka paraqitur asnjë punonjës inxhinier elektronik** të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit

Pra sa mesiper cituar dokumentacioni i paraqitur nga Operatori Ekonomik lidhur me *inxhinier elektronik është i paplotë për rrjedhojë do të konsiderohet i pavlefshëm.*

Së dyti : Nga shqyrtimi i dokumentacionit në sistemin elektronik KVO vëren se operatorët ekonomi nuk kanë arritur të paraqesë dokumentacion për të dëshmuar se disponojnë punonjës me kategori të I, II, III, IV dhe të V të pajisur me deshmë kualifikimi të sigurimit teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente me të , çka bie në kundërshtim me kriterin e kërkuar në DST.

Pra sa më sipër cituar dokumentacioni i paraqitur nga Operatorëve Ekonomik lidhur me Kriteret e Veçanta të Kualifikimit/ Kapaciteti pika 7, është i paplotë, **për rrjedhojë i pavlefshëm.**

Së treti: Autoriteti Kontraktor ka kërkuar ti vihet në dispozicion dy punonjës manovratorë të mjeteve të rënda nga të cilët një automakiniste dhe një eskavatoriste për ekzekutimin e kontratës. Operatori Ekonomik në përmbushje të kriterit të mësipërm nuk ka paraqitur asnjë punonjës manovrator automakinist dhe eskavatorist i cili figuronë në listpagesat e shoqërisë për tre muajt e fundit. Për rrjedhojë dokumentacioni i paraqitur nga shoqëria për të përmbushur kriterin e mësipërm është i paplotë për rrjedhojë i pavlefshëm.

Për sa më sipër Dokumentacioni i paraqitur nga Operatori Ekonomik “SENKA” sh.p.k është i paplotë pasi nuk ka përmbushur kriteret e Veçanta të Kualifikimit/ Kapaciteti Teknik duke mos paraqitur punonjësit manovrator/ automakinist dhe eskavatorist (copë 2) të kërkuar nga AK;

Pra sa më sipër Shoqëria “SENKA” sh.p.k nuk zotëron kapacitet të mjaftueshëm teknik për sa i përket **personelit të nevojshëm** për të realizuar kontratën për këtë objekt prokurimi duke mos përmbushur Kriteret e veçanta për kualifikim, Kapaciteti Teknik dhe profesional, , çka bie në kundërshtim me pikën 1 gërma (a) dhe (b) të nenit 46 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar ku përcaktohet se: *Operatorët ekonomik, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtëme që AK i vlerëson të nevojshme.....*

Së katërt: Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur nga operatorët ekonomikë në sistemin elektronik në përmbushje të kriterit të kërkuar në pikën 13 të kushteve të veçanta të DST por gjithashtu edhe kërkesë taksative e përcaktuar në dokumentat standarte të tenderit të miratuara nga Agjensia e Prokurimit Publik vëren se operatori ekonomik nuk kanë arritur të paraqesin shtojcën 10 (mbi disponimin e makinerive) dhe asnjë mjet të kërkuar sipas kësaj shtojce në kundërshtim kjo me kushtet e përcaktuara në DST.

Sqarojmë operatorët ekonomikë se Komisioni i Vlerësimit të Ofertave verifikon vetëm mjetet që përmban deklarata mbi disponueshmërinë e makinerive të dorëzuar nga operatorët ekonomikë.

Pra sa më sipër Shoqëria "SENKA" sh.p.k nuk zotëron kapacitet të mjaftueshem teknik për sa i përket mjeteve për të realizuar kontratën për këtë objekt prokurimi duke mos përmbushur Kriteret e veçanta për kualifikim, Kapaciteti Teknik dhe profesional, cka bie në kundërshtim me pikën 1 gërma (a) dhe (b) të nenit 46 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin Publik" i ndryshuar ku përcaktohet se:Operatorët ekonomik, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtëme që AK i vlerëson të nevojshme.....

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 53 pika 5, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për Prokurimin publik" (i ndryshuar) dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", Kreu VII, Neni 66 pika 3, **e shpall të pavlefshme** këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

4. Oferta e paraqitur nga Operatori Ekonomik "KUPA" SHPK me vlerë të ofertës 26.063.537,85 (njëzet e gjashtë milion e gjashtëdhjetë e tre mijë e pesëqind e tridhjetë e tre presje tetëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi realizoi kontrollin për gabime aritmetike të ofertës së paraqitur në tender në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.914, datë 29.12.2014 për "Miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar neni 66, konstatoi se oferta është paraqitur pa gabime aritmetike në vlera.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të nenit 53 të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për "Prokurimin publik", i ndryshuar, dhe Kreut VII, neni 66, pika 3 të VKM Nr.914, datë 29.12.2014 për "Miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga ky Operator ekonomik, nga ku rezultoi si më poshtë:

Se pari; Nga verifikimi i makinerive të deklaruara në shtojcën 10 nga operatori ekonomik konstatohet se operatori ekonomik "KUPA" SHPK nuk ka deklaruar eskavatorin me goma 0.25 m3 te paraqitur ne sistem me kontratë Nr.3220Rep Nr.366/1Kol datë 24.06.2011.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave gjykon dhe verifikon vetëm mjetet që përmban deklarata mbi disponueshmërinë e makinerive të dorëzuar nga operatori ekonomik.

Në kushtet kur operatori ekonomik nuk ka deklaruar eskavatorin me goma në shtojcën 10 tregon qartazi se operatori ekonomik "KUPA" SHPK nuk e disponon dhe nuk zotëron këtë mjet për të realizuar kontratën objekt prokurimi.

Autoriteti Kontraktor ka kërkuar ti vihet në dispozicion tre kamion vetëshkarkues **kapaciteti mbajtës duhet të jetë minimum 3.5 ton dhe maximum 5 ton secilin** kamion për ekzekutimin e kontratës. Operatori Ekonomik në përmbushje të këtij kriteri nuk ka paraqitur asnjë kamion me tonazhin e kërkuar nga AK.

Pra sa më sipër cituar dokumentacioni i paraqitur nga Operatori Ekonomik lidhur me shtojcën 10, është i paplotë lidhur me kamionë vetshkarkues me kapacitet mbajtes minimumi 3.5 ton dhe maksimumi 5 ton për secilin kamionçinë te kerkuar nga AK (3 cope), **për rrjedhojë i pavlefshëm.**

Autoriteti Kontraktor ka kërkuar ti vihet në dispozicion 1 eskavator me goma për ekzekutimin e

kontratës. Operatori Ekonomik në përmbushje të kriterit të mësipërm nuk ka paraqitur asnjë eskavator me goma të kërkuar nga AK në dokumentat standarte te tenderit.

Pra sa më sipër cituar dokumentacioni i paraqitur nga Operatori Ekonomik lidhur me shtojcën 10, është i paplotë lidhur me eskavator me goma te kerkuar nga AK (1 cope), **për rrjedhojë i pavlefshëm.**

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 53 pika 5, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu VII, Neni 66 pika 3, **e shpall të pavlefshme** këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Bashkimin i Operatoreve ekonomik “**L.T.E Construction shpk & “Shendelli” shpk** përfaqësuar me prokurë të posaçme nr.240 rep. dhe nr.71 kol. nga shoqeria “L.T.E Construction shpk, me numër NIPT-i K07924803N me adresë: Lagjia “Kastiot”, Dy kullat, Fier, me vlerë prej **24.592.244** (njëzetë e katër milion e pesëqind e nëntëdhjetë e dy mijë e dyqind e dyzetë e katër) lekë pa TVSH.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Ujësjiellës Kanalizime Tiranë sh.a me adresë rruga e Kavajës Nr.133, Njësia administrative Nr.6, Kodi postar 1027, Tiranë, Shqipëri, Tel: 00 355 42240978, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga dita e marrjes të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 29.01.2019

Ankesa: Nuk ka patur.